

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM NOTASH QË PËRDITËSON MARRËVESHJEN, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ZYRËS SË POLICISË EVROPIANE (EUROPOL), PËR BASHKËPUNIMIN STRATEGJIK DHE OPERACIONAL, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.28/2014”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji që po paraqitet për miratim, ka si qëllim miratimin e amendimit të aneksit I të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (EUROPOL) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, e cila është ratifikuar me ligjin nr.28/2014. Këto amendime janë propozuar në kuadër të ndryshimeve statutoire të Europol-it.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është hartuar në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, ratifikuar me ligj.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Në datën 1 maj 2017 ka hyrë në fuqi rregullorja e re e Europol-it dhe, si rrjedhojë, ka ndryshuar dhe kuadri i ligjor i saj. Mandati i ri i Europol-it mbulon vepra penale, të cilat kanë të bëjnë me krimet e rënda, terrorizmin dhe format e tjera të krimit, që prekin dy ose më shumë vende të Bashkimit Evropian, ashtu siç është listuar edhe në aneksin I të rregullores së re të Europol-it. Projektligji do të kontribuojë për të rritur bashkëpunimin në luftën kundër formave të rënda të krimit ndërkombëtar, si dhe në kuadër të angazhimeve të ndërmarra nga Shqipëria për përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit për luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Në nenin 25 të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (EUROPOL) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional,

e cila është ratifikuar me ligjin nr.28/2014, është parashikuar që anekset e kësaj marrëveshjeje dhe dispozitat e nenit 3 (3) mund të ndryshohen përmes shkëmbimit të notave ndërmjet palëve.

Duke iu referuar kësaj dispozite, drejtori i Europol-it ka dërguar një formatnote, bashkëlidhur projektvendimit, me anë të së cilës kërkohet të përditësohet përmbajtja e aneksit I të marrëveshjes.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Paraqitja për miratim e këtij projektakti është në përputhje me nenin 81, pika 1, dhe 100 të Kushtetutës, si dhe me nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe është iniciuar në zbatim të nenin 25 të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (EUROPOL), për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, ratifikuar me ligjin nr.28/2014.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji synon përditësimin e aneksit I të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (EUROPOL), për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, të ratifikuar me ligjin nr.28/2014, në përputhje me nenin 25 të marrëveshjes. Pjesë e projektaktit janë letra e drejtorit ekzekutiv të Europol-it, aneksi I, i përditësuar dhe letra konfirmuese, me anë të së cilës pala shqiptare pranon përditësimin e aneksit I.

Lidhur me hyrjen në fuqi të projektmarrëveshjes, kjo e fundit do të hyjë në fuqi pasi të ratifikohet me ligj dhe t’i dërgohet letra konfirmuese për hyrjen në fuqi të drejtorit ekzekutiv të Europol-it, duke pasur parasysh që sipas formulimit të letrës konfirmuese, marrëveshja hyn në fuqi me dërgimin e kësaj letre nga pala shqiptare.

Ministria e Brendshme do të propozojë Ministrin e Brendshëm si subjekt nënshkrues të kësaj marrëveshjeje dhe, pas ratifikimit të saj në Kuvend do të nisë procedurat për marrjen e plotfuqisë nga Presidenti i Republikës për nënshkrimin e letrës konfirmuese.

VII.INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ashtu siç është përcaktuar edhe në nenin 7 të marrëveshjes dhe në aneksin 2, autoritetet kompetente për zbatimin e këtij projektligji janë të gjitha organet publike, ekzistuese në Republikën e Shqipërisë, përgjegjëse sipas ligjit kombëtar për parandalimin dhe luftimin e veprave penale.

VIII.RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk parashikon shpenzime buxhetore.

KËSHILLI I MINISTRAVE